



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH. nr. 119/17**

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK** i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje **Ekrem Salihu –Kryetar, Nuhi Paçarizi-Referues dhe Tefik Sylejmani-Anëtar**, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 119/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **“DWH-Kosova” sh.p.k.** me seli Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me GPS”** me nr. të prokurimit 70433702/17/115/121, të shpallur nga autoriteti kontraktues–Hidroregjioni Jugor SH.A- Prizren, në seancën e dt. 24 maj 2017, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet**, ankesa e operatorit **“DWH-Kosova” sh.p.k.** me seli Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me GPS”** me nr. të prokurimit 70433702/17/115/121, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Hidroregjioni Jugor SH.A- Prizren, si e bazuar.
- II. Anulohet**, vendimi i autoritetit kontraktues Hidroregjioni Jugor SH.A- Prizren, njoftim për kontratë, për aktivitetin të prokurimit me titull: **“Furnizim me GPS”** me nr. të prokurimit 70433702/17/115/121, dhe lënda kthehet ne ri tenderim.
- III.** Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim .
- IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.
- V.** Operatorit ekonomik ankues **“DWH-Kosova” sh.p.k.** me seli Prishtinë, konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

VI. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues–Hidroregjioni Jugor SH.A- Prizren, më dt. 04 prill 2017, ka publikuar *Njoftim për kontratë* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me GPS”** me nr. të prokurimit 70433702/17/115/121.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Kundër vendimit për refuzimi të kërkesës për rishqyrtim të dt. 21 prill 2017, operatori ekonomik “DWH” sh.p.k. me seli Prishtinë, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-ë.

### Pikat e ankesës:

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 LPP-së, sepse në specifikimet teknike në dosjen e tenderit kërkohen 226 kanale, kur të kapshme janë jo me shumë se 20 satelite. Pra, mund të kërkohen 70, 80, 90, 100, po ashtu mund të kërkohen ne rast se duhen produkte maksimalisht të mira mbi 400, 410 apo 420. Por, nuk mund të kërkohen 226, tamam si edhe jepet ne data sheet të prodhuesit të para preferuar.

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 02 maj 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik, me datën 15 maj 2017, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raport lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin se pas shqyrtimit të lëndës, kërkimeve të bërë, si dhe pas ofrimit të dëshmive shtesë të ofruara nga operatori ekonomik ankues, vjen ne përfundon që është vetëm një prodhues dhe një kompani që ofron GPS me 226 kanale, që paraqet favorizim të vetëm të një operatori ekonomik, duke përjashtuar operatorët ekonomik të tjera nga mundësia e konkurrimit.



Eksperti teknik në raportin e ekspertizës sqaron, edhe përkundër arsytimit (për shkak të specifikave të terrenit), autoritetit kontraktues KRU “HidroRegjioni Jugor”, ka kërkuar një pajisje GPS 226 kanalesh e që kriteret për këtë pajisje mund t’i ofrojë vetëm një prodhues dhe vetëm një operator ekonomik. Nga kjo shihet që paraqet favorizim të një operatori ekonomik. Prandaj, duhet që AK KRU “HidroRegjioni Jugor”, të rishqyrtojë specifikat teknike për pajisjen dhe të krijojë hapësirë që të mund të konkurrojnë edhe të tjerë operator ekonomik.

Bazuar në atë që u tha më lartë, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik ankues, ndërsa të anuloj vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për kontratë të dt. 04 prill 2017.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të dt. 19 maj 2017, e njofton panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues/teknik të dhënë në raportin e ekspertizës së dt. 15 maj 2017.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresë me shkrim të dt. 17 maj 2017, e njofton panelin shqyrtues se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues/teknik të dhënë në raportin e ekspertizës së dt. 15 maj 2017.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, dosja e tenderit, ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues i dt. 15 maj 2017 si dhe parashtresën e autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues.

Ekspertja shqyrtues e prokurimit znj. Bullatovci deklaroj: gjitha pretendimeve ankimore janë shqyrtuar nga eksperti teknik, andaj përgjigjet në pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues i gjeni detajisht të përshkruara në raportin e ekspertizës së dt. 15 maj 2017.

Pretendimi i operatorit ekonomik ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, paneli shqyrtues konstaton se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin se autoriteti kontraktues ka hartuar specifikimet teknike duke ju përshtatur prodhuesve të caktuar, ndërsa në bazë të nenit 28 paragrafi 2 i LPP-së, autoriteti kontraktues është obliguar t’i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, konstatimeve të cekura në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues/teknik, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatoj se autoriteti kontraktues me rastin e hartimi të specifikimeve teknike në dosjen e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me GPS”** me nr .prok. 70433702/17/115/121, nuk ka respektuar nenin 7 dhe nenin 28 të LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

#### **KSHILLA JURIDIKE :**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

**Kryesuesi i Panelit Shqyrtues**



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 ekzemplar – OE “DWH” sh.p.k. Prishtinë
- 1x1 ekzemplar - AK- Hidroregjioni Jugor SH.A- Prizren
- 1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së